

VENDIM
Nr. 92, datë 6.2.2013

**PËR HAPJEN E PIKËS SË PËRBASHKËT TË KALIMIT NDËRKUFITAR NË TREBISHT TË
RRETHIT TË BULQIZËS, NË KUFIRIN SHTETËROR TOKËSOR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË ME MAQEDONINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 9861, datë 24.1.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e pikës së përbashkët të kalimit ndërkufitar (lokale) në Trebisht të rrethit të Bulqizës, në kufirin shtetëror tokësor të Republikës së Shqipërisë me Maqedoninë, për qarkullim lokal të shtetasve dhe autoveturave.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha